

Përdorimi i bimëve mbuluese në prodhimin e bimëve mjekësore dhe aromatike

Përfitimet dhe zbatimi

Mbjellja e bimëve mbuluese është një praktikë e rëndësishme në bujqësinë organike. Duke prodhuar biomasë shtesë midis dy kulturave kryesore, ato përmirësojnë pjellorinë, strukturën dhe shëndetin e tokës dhe parandalojnë erozionin. Mbjellja e bimëve mbuluese është në përputhje me parimet e bujqësisë organike të cilat synojnë ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu është një nga veprimet kryesore që fermerët mund të ndërmarrin për t'i bërë tokat e tyre më të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike.

Ky udhëzues ofron një pasqyrë të përgjithshme të përfitimeve dhe sfidave të kultivimit të bimëve mbuluese dhe jep udhëzime praktike mbi përzgjedhjen e këtyre bimëve.



Përfitimet e përdorimit të bimëve mbuluese

Bimët mbuluese mund të ofrojnë përfitime të shumta në qarkullimin bimor gjatë kultivimit të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA).



Furnizimi me lëndë ushqyese për bimët kryesore

- Bimët mbuluese pasurojnë shtresën sipërfaqësore të tokës duke thithur lëndë ushqyese për bimët nga shtresat më të thella të tokës.
- Bimët mbuluese si bishtajoret pasurojnë tokën me azot të marr nga atmosfera, kështu zvogëlojnë nevojën për plehra komerciale.
- Lëngjet (sekrecioni) që lirohet nga rrënjët ushqejnë organizmat e tokës, nxisin aktivitetin mikrobiologjik në zonën e rrënjëve. Kjo përmirëson pH-in e tokës dhe rrit sasinë e lëndëve ushqyese.
- Furnizimi vjetor i përgjithshëm me azot (N) nga bimët mbuluese sillet nga 20 deri në 200 kg N për ha. Përderisa bimët jo-bishtajoret sigurojnë 2,5 kg N për ha për ton masë të freskët, bishtajoret sigurojnë rreth 4 kg N për ha. Sa më e gjatë të jetë kohëzgjatja e rritjes së bishtajoreve, aq më shumë azot fiksohet-sigurohet në tokë.



Parandalimi i humbjeve të lëndëve ushqyese

Në tokat e ngrohta në vjeshtë, lënda organike mineralizohet me shpejtësi, duke rritur nivelet e azotit (nitratit) të tretshëm në ujë. Nëse në tokë nuk ka bimë që thithin azotin (nëse toka lihet e zhveshur gjatë dimrit), ky azot humbet nëpërmjet shpëlarjes, duke ndotur ujërat nëntokësore dhe rrugët ujore. Bimët mbuluese të mbjella në kohë, veçanërisht bimët jo-bishtajore, mund të mbajnë pjesën më të madhe të azotit të tretshëm.



Rritja e pjellorisë së tokës

- Lënda organike e tokës rrit depërtimin e ujit dhe përmirëson aftësinë e tokës për të ruajtur dhe liruar vazhdimisht lëndë ushqyese dhe ujë, duke krijuar kushte më të mira të rritjes dhe duke zvogëluar stresin e bimëve gjatë periudhave të thatësirës.
- Bimët mbuluese me strukturë 'drunore' mund të rrisin nivelet e lëndës organike në tokë.



Ulja e erozionit

- Bimët mbuluese sigurojnë mbulimin e tokës midis kulturave kryesore duke minimizuar ndikimin e shiut dhe erozionin sipërfaqësor të tokës.
- Për më tepër, bimët mbuluese përmirësojnë depërtimin e ujit përmes rritjes së aktivitetit të krimbave të tokës dhe krijojnë një strukturë më të mirë të shtresës sipërfaqësore të tokës.



Kontrolli i barojave

- Bimët mbuluese me rritje të shpejtë dhe të dendura (p.sh. mustarda ose grurëzi-hejdë e rëndomtë) konkurrojnë në mënyrë efektive me barojat në shfrytëzimin e dritës, ujit dhe lëndëve ushqyese. Ato mund të parandalojnë ose zvogëlojnë zhvillimin, përhapjen dhe përhapjen e farave të tyre.
- Livadhet artificiale njëvjeçare ose shumëvjeçare janë ideale, të nevojshme për të kontrolluar barojat rrënjore, siç janë Grami i shtrirë ose Gjemb i arave.



Veçanërisht llojet e e bimëve për plehrim të gjelbër me rritje të shpejtë, të tilla si facelia, tërfili aleksandrin, grashinë me tufëza, tërshëra dhe grurëzi-hejdë e rëndomtë, janë shumë konkurruese kundër barojave të këqija.



Plehrat e gjelbra nxisin aktivitetin biologjik në tokë dhe ndihmojnë në ruajtjen e pjellorisë së saj.



Biodiversiteti funksional i tokës

- Bimët mbuluese jo-nikoqire kontribuojnë në ndërprerjen e cikleve jetësore të dëmtuesve dhe sëmundjeve.
- Disa bimët mbuluese (p.sh., kalendula, tërshëra e zhveshur) mund të përdoren për të kontrolluar nematodat.
- Përfshirja sipërfaqësore e specieve alelopatike (bimë që çlirojnë substanca kimike në mjedisin përreth) si mustarda, rrepë e kultivuar dhe rrepë vajore, të cilat mund të zvogëlojnë përhapjen e sëmundjeve në tokë. Kjo praktikë njihet si 'biofumigim' (Dezinfektim biologjik i tokës).



Përdorimi i mundshëm i foragjereve

- Disa bimë mbuluese mund të përdoren si ushqim për kafshë. Fermat që nuk kanë bagëti, mund të ofrojnë bimët mbuluese për ushqimin e kafshëve, në këmbim marrin pleh organik për plehërimin e bimëve.
- Për cilësi të lartë të ushqimit, bimët mbuluese duhet të vjelen në një fazë të përshtatshme për përdorim si bimë foragjere.

Sfidat e mundshme

Mungesa e sasisë së ujit

Nëse bima mbuluese mbështetet shumë në rezervat e ujit të tokës, atëherë sasia e ujit për bimën kryesore pasuese mund të jetë e kufizuar. Veçanërisht në pranverë, kur rezervat e ujit mund të jenë të ulëta, sasia e ujit mund të bëhet kritike.

Çfarë duhet bërë:

- Zgjidhni bimët mbuluese me kërkesa minimale për ujë. Kultivoni bimë mbuluese me kërkesë më të lartë për ujë vetëm në stinët me shi.
- Mbillni bimët mbuluese herët (4 deri në 6 javë para mbjelljes së bimës pasardhëse) në shtresën sipërfaqësore të tokës (p.sh. duke përdorur lëvrim të cekët) për të siguruar nivele më të larta të lagështisë së tokës.

Ri-kultivimi i bimëve me vlerë tregtare

Disa lloje të bimëve mbuluese mund të piquen shpejt dhe të prodhojnë fara të qëndrueshme. Mbirja e farërave të bimëve mbuluese me vlerë tregtare mund të jetë një problem i madh.

Çfarë duhet bërë:

- Zgjidhni llojet e bimëve mbuluese sipas periudhës së rritjes në dispozicion.
- Nëse është e nevojshme, përcaktojeni datën e shkatërrimit të bimës mbuluese menjëherë pas lulëzimit për të parandaluar formimin e farave.
- Nëse bima mbuluese ka kaluar në fazën e krijimit të farërave, përgatitni shtratin e farës në pranverë dy herë brenda dy javësh. Së pari, për të stimuluar mbirjen e farave, dhe pastaj dy javë më vonë, për t'i shkatërruar ato, përpara se të mbillni bimën me vlerë tregtare.

Përhapja e dëmtuesve dhe sëmundjeve

Bimët mbuluese mund të strehojnë patogjenë që mund të ndikojnë në bimët pasuese me vlerë tregtare.

Çfarë duhet bërë:

- Zgjidhni lloje të bimëve mbuluese nga familje të tjera botanike përveç bimëve me vlerë tregtare

(p.sh., jo luledielli para kamomilit, pasi të dyja i përkasin familjes *Asteraceae*).

- Mbillni-kultivoni lloje të ndryshme të bimëve mbuluese.
- Ndërroni familjet e bimëve mbuluese në stinë të ndryshme.

Prodhimi i substancave toksike-helmuese

Bimët me Alkaloidet Pirolizidinë (PA) janë një sfidë e madhe tek BMA-të. Ato gjenden natyrshëm në shumë bimë dhe baroja, kryesisht paraqiten si një mekanizëm për të larguar dëmtuesit. Ato janë shumë toksike për njerëzit, për këtë në raste të ndryshme kanë bërë që një pjesë e produkteve të tërhiqen nga tregu: p.sh disa çajrave, përzierjeve të bimëve të kuzhinës, etj.

Çfarë duhet bërë:

- Në fushat të njohura për paraqitjen e tyre, rrisni dendësinë e bimës mbuluese për të shkatërruar çdo bimë tjetër. Nëse gjenden bimë toksike në bimën mbuluese, përshpejtoni largimin e saj përpara se të prodhohen fara të qëndrueshme.



Plehu i gjelbër duhet të trajtohet si kulturë primare. Teknikat e mira të mbjelljes dhe kultivimit janë shumë të rëndësishme për të siguruar që ato të formojnë struktura të dendura dhe të fuqishme dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Përdorimi i suksesshëm i bimëve mbuluese

Përgatitja bazë e tokës

- Pas vjeljes së bimës kryesore, përgatitni tokën sa më shpejtë të jetë e mundur, kjo ndihmon për të shfrytëzuar sa më shumë periudhën e rritjes së bimës mbuluese.
- Përdorni një kultivator ose një makinë me tërheqje (PTO) për përgatitjen bazë të tokës. Kultivatori është i përshtatshëm për toka të lehta.
- Punoni thellë tokat e ngjeshura dhe të thata, duke përdorur një lirues të thellë ose me një lërues sipërfaqësor, të shoqëruar më pas me një përzierje bimësh mbuluese me rrënjë të thella, duke përfshirë, për shembull rrepën vajore.
- Kur presioni i barojave është i lartë, mbillni një përzierje të dendur dhe me rritje të shpejtë, siç është grurëzi-hejdë e rëndomtë dhe grashinë me tufëza dhe mel i rëndomtë. Kjo do të parandalojë mbirjen dhe pjekjen e barojave, pasi ato do të zhduken së bashku me bimën mbuluese. Pas përfundimit të bimës mbuluese, përdorni 'teknikën e mbjelljes së rreme', duke përgatitur rendet për mbjellje 2 deri në 3 javë para mbjelljes dhe duke e pastruar atë pas 8 deri në 10 ditë për të shkatërruar farat e mbira të barojave.



Përdorimi i plehut të kafshëve, kompostit të mbeturinave të gjelbra dhe gëlqeres para mbjelljes së bimëve mbuluese rrit sasinë e lëndëve ushqyese për bimët me vlerë tregtare duke parandaluar bllokimin e mundshëm të azotit në tokë.

Plehërim i përshtatshëm

- Nëse është e nevojshme, përdorni pleh organik, kompost dhe/ose gëlqere para përgatitjes së shtratit për mbjellje të farës.
- Përdorni plehra të lëngshme dhe tretje të lëngshme vetëm në bimët mbuluese të vendosura plotësisht për të parandaluar humbjet e azotit.

Mbjellja

- Mbilleni bimën mbuluese menjëherë pasi të jetë vjelur bima kryesore, veçanërisht kur mbillni bimë të ndjeshme ndaj ngricave.
- Në rast të mbjelljes së vonë në vjeshtë, zgjidhni bimët rezistente që do të sigurojnë rritje të vazhdueshme dhe fiksime të lëndëve ushqyese deri në fillim të pranverës.
- Mbjellja me shkallë të lartë siguron formim më të dendur të bimëve dhe kontrollim më të mirë të barojave.
- Nëse është e mundur, përdorni fara organike të certifikuara. Nëse nuk është e mundur, përdorni fara konvencionale të pa trajtuara me miratimin e trupës së certifikimit organik.
- Përdorni një makinë mbjellëse të drithërave në vend të një mbjellëseje me shpërndarje, kjo për të siguruar një dendësi të njëtrajtshme të bimëve dhe mbirje të shpejtë. Për mbjelljen e farës në toka të thata gjatë verës, mbilleni në brazda më të thella, me thellësi 3 deri në 5 cm.



Lëvrimi sipërfaqësor dhe i imët i tokës zakonisht është i mjaftueshëm për të kultivuar bimët mbuluese. Lëvrimi i kufizuar ruan lagështinë e tokës dhe gjithashtu kursen kohë dhe kosto operative gjatë kultivimit të bimëve mbuluese.



Makinat mbjellëse me vrima me gjerësi të vogël shpimi janë veçanërisht të përshtatshme për mbjelljen e bimëve për plehrim të gjelbër. Në kombinim me një rul, ato sigurojnë një mbirje të njëtrajtshme të farës.

Rulimi i tokës menjëherë pas mbjelljes siguron kontakt të mirë të farës me tokën dhe rezulton në një shkallë më të lartë të mbirjes së farës. Llogaritja e normave të farës në përzierje

1. Merrni normat e zakonshme individuale të farës për grumbujt e pastër të secilës kulturë për hektar.
2. Merrni proporcionet e kulturave në përzierje (p.sh., 50 % grashinë verore me tufëza, 25 % rrepë vajore, 25 % facelia)
3. Shumëzoni sasinë e farës me proporcionet (p.sh., grashinë verore me tufëza $0,50 \times 50 \text{ kg/ha} = 25 \text{ kg}$; rrepë vajore $0,25 \times 20 \text{ kg/ha} = 5 \text{ kg}$; facelia $0,25 \times 10 \text{ kg/ha} = 2,5 \text{ kg}$)

E rëndësishme: Nëse bimët shumë dominuese do të përzihen me bimë më të dobëta, normat e farës së bimëve dominuese në përzierje duhet të reduktohen në përputhje me rrethanat!

Përfundimi

- Mbulimi me mulç i bimëve të reja mbuluese 3 deri në 4 javë para mbjelljes së tyre në tokë do të rrisë mineralizimin e azotit, ndërsa largimi i bimëve më të vjetra mund të vonojë ose zvogëlojë sasinë e azotit.
- Pritini ose mbuloni barojat me mulç para se bima të lulëzoj.
- Ideale është që bimët dikotiledone duhet të priten në fillim të lulëzimit.



Ndërprerja e furnizimit me plehrim të gjelbër në lulëzimin e hershëm maksimizon çlirimin e lëndëve ushqyese për bimën pasardhëse dhe parandalon formimin e farave.

- Sigurohuni që të kalojnë të paktën 3 javë midis përfundimit të mbjelljes së bimës mbuluese dhe mbjelljes së bimës pasardhëse, kjo për të mundësuar dekompozimin e biomasës së bimës.
- Shmangni prerjen ose mbulimin me mulç të bimëve mbuluese gjatë lulëzimit të plotë për të mbrojtur insektet që vizitojnë lulet. Për të minimizuar dëmtimin nga insektet, pritini bimët mbuluese natën.
- Prerja në pjesët e larta të bimëve mbuluese nxit rritjen e fuqishme.
- Përdorimi i makinerive në tokë të lagësht mund të shkatërrojë përfitimet që vijnë nga bimët mbuluese.



Përfshirja – përzierja sipërfaqësore e plehut të gjelbër në tokë përshpejton dekompozimin e tij dhe minimizon prishjen e strukturës së tokës.

Llojet e përshtatshme të bimëve mbuluese për BMA-të në Kosovë

Table 1: Lloje bimësh mbuluese me ndjeshmëri ndaj ngricave për kultivim veror pas drithërave

Bima	Emri latin	Lloji/familja	Dendësia e mbjelljes	Detaje
Grashinë verore	<i>Vicia sativa</i>	Bishtajore	50 deri në 65 kg/ha	Tolerancë e mirë ndaj thatësirës dhe fiksimit të azotit
Bizele të vogla	<i>Lathyrus sativa</i>	Bishtajore	50 deri në 65 kg/ha	Tolerancë e mirë ndaj thatësirës dhe fiksimit të azotit
Tërfilli egjiptian	<i>Trifolium alexandrinum</i>	Bishtajore	15 deri në 18 kg/ha	Cilësi i lartë i foragjereve, disa bimë mund të rriten përsëri pas vjeljes së parë
Tërshërë e egër	<i>Avena strigoza</i>	Bar	35 deri në 50 kg/ha	Efekt i fortë alelopatik në baroja, fara të lira
Mel i rëndomtë	<i>Panicum miliaceum</i>	Bar	25 deri në 35 kg/ha	Rritje e shpejtë dhe mbuluese e tokës, rezistente ndaj thatësirës, shumë e ndjeshme ndaj ngricave
Mustardë e bardhë	<i>Sinapis alba</i>	Crucifera	5 deri në 7 kg/ha	Fara të lira, shumë tërheqëse për pjalmuesit, të përshtatshme për biofumigim
Rrepë vajore	<i>Raphanus sativus</i>	Crucifera	18 deri në 20 kg/ha	Përmirëson strukturën e thellë të tokës
Facelia	<i>Phacelia tanacetifolia</i>	Hydrophyllaceae	10 deri në 12 kg/ha	Fiksues i shkëlqyer i azotit, tërheq pjalmuesit, përmirëson strukturën e shtresës së sipërme të tokës
Grurëzi, hejdhë e rëndomtë	<i>Fagopyrum esculentum</i>	Polygonaceae	35 deri në 45 kg/ha	Mbulim i shpejtë, shfrytëzues i fosforit të tokës, rrezik për prodhimin e farës
Niger	<i>Guizotia Abyssinica</i>	Asteraceae	8 deri në 10 kg/ha	Rritje e shpejtë, fiksuese e fortë e azotit, shumë e ndjeshme ndaj ngricave

Table 2: Llojet e bimëve mbuluese dimërore për mbjellje vjeshtore

Bima	Emri latin	Lloji/Familja	Dendësia e mbjelljes	Detaje
Grashinë foragjere	<i>Vicia villosa</i>	Bishtajore	25 deri në 35 kg/ha	Mbulesë shumë e mirë e tokës, fiksimit të azotit
Fasule dimërore	<i>Vicia faba</i>	Bishtajore	120 deri në 180 kg/ha	Rrënjë e fortë (rrënjëzim i thellë i tokës), fiksimit të azotit
Bizelja dimërore	<i>Pisum sativum</i>	Bishtajore	100 deri në 130 kg/ha	Rezistent ndaj ngricave, i lehtë për t'u ndërprerë në pranverë, fiksimit të azotit
Thekër dimërore	<i>Secale drithëra</i>	Bar	60 deri në 70 kg/ha	Përmirësues i mirë i tokës, i vështirë për t'u zhdukur

Përparësitë e përzierjeve


Përzierjet e bishtajoreve dhe jo-bishtajoreve kanë disa përparësi ndaj farave të pastra:

- Ato fiksojnë më shumë azot sesa bimët e pastra të bishtajoreve.
- Bimët jo-bishtajore parandalojnë rrjedhjen e azotit në mënyrë më efektive sesa bishtajoret.
- Përzierjet i përdorin lëndët ushqyese në tokë në mënyrë më efektive, pjesërisht për shkak të zonave të ndryshme të rrënjës.

- Rreziku i përhapjes së dëmtuesve dhe sëmundjeve zvogëlohet.
- Ato përshtaten më mirë me kushtet e ndryshme të kultivimit, duke siguruar prodhim të mirë të biomases.
- Llogaritni normën e farës bazuar në proporcionet e bimëve në përzierje. Nëse një bimë dihet të jetë shumë dominuese, zvogëloni normën e farës së bimës dominuese dhe rrisni normat e bimëve më të dobëta.


Shembuj të qarkullimit bimor të BMA-ve me kultura mbuluese

Shembulli 1: Një bimë mbuluese midis kamomilit dhe grurit




- Mbillni sa më shpejt të jetë e mundur pas lëvrimit të cekët të tokës për të shfrytëzuar sa më shumë kohën e kufizuar në dispozicion për rritjen e bimëve dhe fiksimin e azotit.
- Një përzierje prej tre bishtajoreve 'verore' është e përshtatshme për të rindërtuar pjellorinë për bimët-drihtërave: bizele të vogla (25 kg) + grashinë verore me tufëza (25 kg) + tërfili egjiptian (5 kg).
- 3 deri në 5 kg fara nyjer, për të fiksuar në mënyrë efikase azotin e mbetur dhe për të mbuluar shpejt tokën.

Shembulli 2: Një bimë mbuluese e mbjell ndërmjet vjeljes verore në një plantacion me bimë shumëvjeçar pranveror (p.sh. mente) në toka më të lehta



- Në toka më të lehta që lejojnë lëvrimin në pranverë, një bishtajore dimërore mund të thithë sasi të konsiderueshme të azotit, kryesisht në shkurt dhe mars. Për qëndrueshmëri të mirë ndaj ngricave, mos i mbillni bishtajoret shumë herët (ideale është fillimi i tetorit).
- Bizelja dimërore (100 kg/ha) ose grashinë verore me tufëza (35 kg/ha) janë më të përshtatshmet. Kultivimi më i thellë i kërcejve u lejon bishtajoret të japin rezultate të plota gjatë dimrit dhe pranverës së hershme. Fiksimi i azotit mund të arrijë 200 kg/ha.
- 35 kg shtesë të thekrës dimërore do të ndihmojë në strukturimin e tokës dhe në bllokimin e azotit që rrjedh.

Shembulli 3: Një bimë mbuluese e mbjell ndërmjet vjeljes verore dhe një plantacioni shumëvjeçar pranveror (p.sh. mente) në toka më të rënda



- Në tokat e rënda argjilore, qëllimi është të prodhohet sa më shumë biomasë që është e mundur midis vjeljes dhe lëvrimit në fund të vjeshtës.
- Një përzierje e bizeleve të njoma dhe grashinë me tufëza, me mustardë, grurëzi – hejdhë e rëndomtë, farat nyjer dhe mel i rëndomtë mund të zhvillohet shpejtë në vjeshtë.
- Lëvrimi i cekët i tokës përdoret për të përgatitur një shtrat të mirë farash dhe për të kursyer ujë për mbjellje të shpejtë pas vjeljes.
- Mbulimi me mulç dhe lëvrimi i bimës mbuluese në fund të nëntorit përmirëson pjellorinë e tokës dhe krijon kushte të favorshme për kultivimin e tokës në pranverë.

Emri i publikuesit

Botuesit

Instituti i Kërkimeve të Bujqësisë Organike FiBL
Ackerstrasse 113, Kutia Postare 219, 5070 Frick, Zvicër
Tel. +41 (0)62 865 72 72, info.suisse@fibl.org, fibl.org

Caritas-i Zviceran n
Adligenswilerstrasse 15, PO Box, 6002 Lucernë, Zvicër
Tel. +41 (0) 41 419 22 22, info@caritas.ch, caritas.ch

Autori: Nicolas Lefebvre (FiBL Zvicër)

Rishikimi: Anja Vieweger (FiBL Zvicër)

Redaktorët: Gilles Weidmann, Phie Thanner dhe Elsa Kanner (FiBL Zvicër)

Faqosja: Sandra Walti (FiBL Zvicër)

Fotot: Thomas Alfeldi (FiBL): faqe 4 (2), 5 (1); Hansueli Dierauer (FiBL): fq. 2 (2), 5 (3); Martin Koller (FiBL): fq. 5 (2); Maïke Krauss (FiBL): fq. 4 (1); René Schulte (Bio Suisse): fq. 1, 2 (1); Anja Vieweger (FiBL): fq. 3

Nr. i artikullit FiBL: 1840

Link: orgprints.org/id/eprint/56301/

Citim i sugjeruar: Lefebvre N. (2025). Kulturat mbuluese në prodhimin e bimëve mjekësore dhe aromatike. Përfitimet dhe zbatimi. Instituti i Kërkimeve të Bujqësisë Organike FiBL, Frick.

Falënderime

Ky udhëzues teknik u zhvillua nga FiBL në kuadër të projektit EREA, të zbatuar nga Caritas-i Zviceran dhe financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC).

Mohim përgjegjësie

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e ADC-s ose të Caritas-it Zviceran.

Ky udhëzues është i disponueshëm për shkarkim falas në shop.fibl.org > 1840

I gjithë informacioni në këtë udhëzues bazohet në njohuritë dhe përvojën më të mirë të autorëve. Pavarësisht kujdesit më të madh, pasaktësitë dhe gabimet e aplikimit nuk mund të përjashtohen. Për këtë arsye, autorët dhe botuesit nuk mund të pranojnë asnjë përgjegjësi për ndonjë pasaktësi në përmbajtje, ose për ndonjë dëm që rezulton nga ndjekja e rekomandimeve.

2025 © FiBL

Për të drejtat e autorit shihni fibl.org/en/copyright